

REPUBLIKA E KOSOVES

Kuvendi i Komunes së Prishtinës

Sekretariati i Arsimit

Nr. 44

Prishtinë, më 6.10.1994

Në mbështetje të kërkesës së Udhëheqësisë së Arsimit të Republikës së Kosovës, sekretariati i Arsimit të Komunes së Prishtinës, paraqet këtë

IN F O R M A T E T E S H K U R T E

për Sekretariatit e Arsimit të Komunes së Prishtinës dhe për personat që punojnë në këto organ

Sekretariati i Arsimit të Komunes së Prishtinës është organ shtetëror i Arsimit i cili punët dhe detyrat i kryen në harmoni me kushtetutën e Republikës së Kosovës, të ligjeve dhe të akteve të tjera që rregullojnë lëmin e arsimit dhe të edukimit parashkollor dhe filloor dhe të mesëm.

Ky organ bënë mbikëqyrjen në realizimin e kushtetushmërisë dhe të ligjëshmerisë në 34 shkolla fillore me 31 paralele të ndara fizike në një shkollë fillore speciale në qerdhet e fëmijëve, në 11 shkolla të mesme dhe në institucionet tjera të arsimit që punojnë dhe veprojnë në territorin e komunes së Prishtinës.

Sekretariati i Arsimit, sidomos është i angazhuar në ruajtjen dhe në përparimin e punës institucionale në shkolla, duke i këshilluar dhe udhëzuar për punë në kushtet e okupimit. Përmes të kontrollimeve të rregullta, informative, speciale, dhe kontrolluese ka mbikëqyrë dhe është mbikëqyrë punën e përditshme të shkollave dhe të insticioneve të tjera të arsimit.

Përveq mbikëqyrjes së përditshme ka bartë barrën kryesore për organizimin e punës edukative arsimore në kushte të okupimit, në ndërtesa shkollore, në shtëpi shkolla për krijimin e kushteve sa më të volitshme për organizimin e mësimit. Ka shqyrtuar dhe ka zgjidhur problemet e caktuara të shkollave, të arsimtarëve të nxënësve dhe të palëve të

palëve të interesuara.

Punëtorët e Sekretariatit të Arsimit prej vitit 1991-92 kanë qënë të vendosur në Shkollën fillore "Emin Duraku" në Prishtinë, ndërsa nga 13 prill 1992 deri me 20 qershor 1994 selin e kanë pasur në ^{shtëpi} selinë e Basri Gashit, rruga e Llapit, nr.37. Në këtë shtëpi së bashku me Entin pedagogjik të Republikës së Kosovës, Entin Pedagogjik të komunës së Prishtinës dhe Sindikatën e Pavarur të Arsimit kanë qënë të vendosur falas. Nga 21 qershori e deri 25 shtator 1994 organi ka qënë i vendosur në Shkollën fillore "Nazim Gafurri" në Prishtinë. Tani është i vendosur në Velani edhe këtë falas, por këto lokale janë larg qendres së qytetit dhe nuk janë të përshatshme për punë sepse aty e organizon mësimin edhe shkolë e mesme e Makinerisë "Shtjefën Gjeçovi". Kësaj rradhe nuk e kemi ndërmend të shkruajmë për vërtetësitë në punë të natyrës objektive të diktuar nga kushtet në të cilat vepron arsimit në Kosovë dhe në Prishtinë si dhe as për keqtrajtimet burgosjet dhe format tjere të dhunës që ka aplikuar pushteti serbë ndaj punëtorëve të këtij organi.

Në Sekretariatit të Arsimit të Komunës së Prishtinës punojnë: Zijedin Gashi, sekretar i sekretariatit të Arsimit, Halim Halimi inspektor i arsimit dhe i punës dhe Nazmi Çaka i angazhuar prej 1 shtatorii 1992 që përkohësisht i kryen punët e inspektorit të arsimit.

1. Zijedin Gashi, u lind më 5 maj 1944 në fshatin Busi-Mramuer Komuna e Prishtinës. Banon në Prishtinë. Ka të kryer fakultetin filozofik dega e Historisë. Prej vitit 1964 deri më 1971 punoi si arsimtar në shkollën fillore "Avni Rrustemi" në Mramuer (pat ndërprerje të punës gjat shërbimit ushtarak që shërbeu prej 28. mars 1966 e der më 9 shtator 1967). Në vitin 1971 punoi si arsimtar në shkollën fillore "Ganimete Tërbeshi" në Llukar, ndërsa në gjymësvjetorin e dytë të vitit shkollor 1971/72 punoi si profesor i historisë në shkollën ekonomike në Prishtinë. Që nga 1 shtatori i vitit 1972 deri më 10 shkurt 1976 punoi si profesor i historisë në gjimnazin "Xhevdet Doda" në Prishtinë. Prej vitit 1976 deri më 1 mars 1991 punoi si inspektor i arsimit në komunën e Prishtinës. Me rastin e aplikimit të masave të dhunëshme në këtë organ u përjashtua nga puna. Ka rreth 28 vjetë stazh pune në arsim.

Zijedin Gashi është emëruar sekretar i Sekretariatit të Komunës së Prishtinës në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të mbajtur më 1 shturt 1992. Megjithëse, prej vitit shkollor 1990/91, praktikisht kryente

detyrë dhe detyrat tjera të organit komunal për arsim që kishin të bënin me organizimin e mësimit në gjuhën shqipe.

Është një ndër të parët që dhe kontributin për prganizimin insti-tucional të mësimit në gjuhën shqipe prej vitit shkollor 1990/91 e këndej në Komunë dhe në Kosovë. Është antar i kryesisi të LASH-it "Naim Frashëri". Më 24 maj 1992 u zgjodh deputet i Republikës së Kosovës.

Është antar i grupit të autorizuar për udhëheqjen e arsimit fillor dhe të mesëm në Republikën e Kosovës. Duke vrejtur nevojën për ndrrimet e domosdoshme që imponoi koha dhe për plotësimin e zbrastësis për qeverisjen e shkollës si dhe për mbajtjen dhe udhëheqjen e evidencës arsimore edukati-ve në kushte të okupimit, me autorizimin e grupit, përkatësisht të Ministris të arsimit të Republikës së Kosovës, personalisht përpiloi, përshtati dhe shkroi:

- Projektligjin për arsimin dhe edukimin fillor (versioni I, II dhe III),
- Projektligjin për arsimin dhe edukimin e mesëm (versioni I, II dhe III),
- Një numër të konsideruar të Rregulloreve dhe të akteve tjera nën-ligjore që rregullojnë arsimin fillor dhe të mesëm,
- Formularët e librit të klasës (ditarit të punës) për shkollë fillo-re,
- Formularët e librit të klasës (ditarët të punës) për shkollë të mesme,
- Formularët e Librit amë për nxënësit e shkollës fillore,
- Formularët e librit për regjistrimin e fëmijve në klasën e parë të shkollës fillore,
- Formularët e regjistrit për lëshimin e dëftesëve për kryerjen e shkollës fillore,
- Formularët e Librit amë për nxënësit e shkollave të mesme,
- Formularin e regjistrit për lëshimin e diplomave të nxënësve të shkollave të mesme,
- Formularin e Librit amë të puntorëve të shkollës,
- Formularin e dëftesës për kryerjen e shkollës fillore,
- Formularin e dëftesës për kryerjen e klasës së shkollës së mesme,
- Formularin e diplomës për kryerjen e shkollës së mesme,
- Formularin e librezës për nxënësit e shkollës fillore,
- Formularin e ditarit të punës për mësimit në botën e jashtme,
- Formularin e librezës për nxënësit në botën e jashtme,

...istën e emrave për emërtimin e institucioneve edukativo-arsimore,
-Udhëzimet për organizimin e provimeve të klasës në kushte të okupi-
t, etj.

-Ka qenë anëtar i Komisionit për emërtimin e institucioneve edukativo-arsimore, i Komisionit për themelimin dhe ndarjen e shkollave dhe anëtar i disa komisioneve të përkohëshme të grupit për arsim. Dhjetra herë me autorizime të grupit për arsim ka vizituar numrin më të madh të komunave të Republikës së Kosovës për të dhënë udhëzime praktike lidhur me organizimin e provës edukativo-arsimore në kushte të okupimit.

Për grupin e arsimit përkatësisht për Ministrin e Arsimit të Republikës së Kosovës, kryesisht i ka kryer punët juridike dhe të praktikës shkollore, ndërsa si sekretar i arsimit të Komunës së Prishtinës i kryen punët dhe detyrat në bazë të Ligjit mbi administratën shtetërore dhe të ligjeve që rregullojnë çështje të arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm.

2. Nazmi Caka, është angazhuar për inspektor të arsimit nga sekretari i arsimit të Komunës së Prishtinës me 1 shtator 1992. Punët dhe detyrat e inspektorit të arsimit i ka kryer dhe i kryen me profesionalizëm dhe korrektësi. Ka bërë mbikqyrjen në realizimin e ligjëshmerisë në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të komunës së Prishtinës. Qëndrimi ndaj punës së inspektorit e ka pasur të drejtë po ashtu edhe ndaj palëve të interesuara për arsim. Megjithatë është bashkëpunor i lartë profesional në Plegësinë e Arsimit të Kosovës ku merr edhe kompenzimin material, dhe është kryetar i Komisionit për nostrifikim dhe bashkëpunor i Entit pedagogjic të Kosovës për gjuhë frënge dhe gjuhë latine, punët e inspektorit të arsimit i ka kryer në mënyrë vullnetare-pa kompensim material.

Shenimet e nevojshme personale i dërgon nëpërmes Plegësisë së Arsimit të Republikës së Kosovës ose nëpërmes të Komisionit për nostrifikim.

3. Halim Halimi u lind më 1955 në Nishevc Komuna e Prishtinës. Banon në Prishtinë. Ka të kryer fakultetin juridik. Prej vitit 1975-77 ka punuar si arsimtar në shkollën fillore "Rilindja" në Keqekollë, paralelja e ndarë në Nishevc. Në vitin 1981 dhe në vitin 1983 ishte praktikant në gjyqjin e Qarkut në Prishtinë, ndërsa që nga viti 1983-87 punoi si shef i punëve të përgjithëshme, përkatësisht ishte sekretar i fakultetit të bujqësisë së Prishtinës. Në vitet 1987-92 punoi si inspektor i punës në Komunën e Prishtinës. Ka rreth 18 vjetë stazh pune.

Prej 1 shkurti 1993 me Vendimin e sekretarit të arsimit të komunës së Prishtinës kryen punët e inspektorit të arsimit. Megjithatë më parë ka punuar si inspektor i punës, përveç mbikqyrjes në realizimin e ligjëshmërisë në arsim kryen edhe mbikqyrjen e drejtës së punës në shkollat e komunës së Prishtinës. Punën e inspektorit e kryen me profesionalizëm dhe korrektësi.

Sekretari i Arsimit
Zijadin Gashi

Zijadin Gashi